

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Debllokimi I bunkerit te zgures B1 dhe B2**

Sa i përket tenderit për **2026/KEK-26-1014-5-2-1/B05-0004223**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

AR-Tech SH.P.K, Prishtine

10 000, Prishtine, Kosove

Tel +383 45 707 606

Fazli Cakiqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

E-mail: artech.shpk@gmail.com

30.06.2026

(Nënshkrimi dhe vula)



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate publikuar me date 16.03.2026
Afati i dorezimit te tenderëve 07.04.2026
Data e hapjes se tenderve 07.04.2026
Njoftimi mbi vendimin e AK 10.06.2026
Kerkesa per Rishqyrtim 15.06.2026
Vendimi i AK mbi refuzimin e Kerkeses per rishqyrtim 22.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Nuk kam vërejtje. Hapja permes platformes

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Ne përputhje me nenin 108/a të LPP-së, kemi parashtruar Kërkesë për rishqyrtim brenda afateve kohore, respektivisht më datë 15.06.2026. Më datë 22.06.2026, AK ka nxjerrë vendim për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP - Qëllimi

Neni 6 i LPP - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 i LPP - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 i LPP - Kriteret për Dhënie e Kontratës

Neni 61.3 i RPP - Pezullimi i aktivitetit të prokurimit

Neni 63.2 i RPP - Vendimi i Autoritetit Kontraktues

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne paraqesim këtë ankesë për rishqyrtim ndaj vendimit për eliminimin e ofertës sonë, duke konsideruar se vendimi është marrë në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Oferta jonë në vlerë prej **39,825.00 €** është oferta e përgjegjshme me cmimin më të ulët në këtë procedurë.

Pretendimi 1 - Lidhur me mosplotësimin e kapacitetit teknik dhe

profesional

Kërkesa e Dosjes së Tenderit

Në Seksionin II – Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), neni 9.1 dhe 9.2, si dhe në Njoftimin për Kontratë, neni 111.2.4 "Kapaciteti teknik dhe profesional", është kërkuar:

"Posedimi i stafit: Së paku tre (3) punëtorë për kryerjen e punëve në lartësi të mëdha. Të dëshmohet me kopje të certifikatës së mjekut për punë në lartësi, kontratë ose parakontratë dhe CV."

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues ne letren standarde

Në vendimin për eliminim është konstatuar se: "*Në ofertë keni dorëzuar dokumentin 'Certifikatë Shëndetësore', por nuk është specifikuar/përcaktuar për punë në lartësi.*" Bazuar në këtë konstatim, AK ka vlerësuar se nuk kemi plotësuar kriterin e kërkuar.

Argumenti 1

Ky konstatim nuk qëndron dhe është rezultat i një interpretimi të gabuar të dokumentacionit të dorëzuar.

Së pari, Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar ndonjë **formë, model apo tekst të detyrueshëm** që duhet të përmbajë certifikata mjekësore. Kërkesa e vetme ka qenë dorëzimi i një certifikate mjekësore për punëtorët e angazhuar për kryerjen e punëve në lartësi.

Ne kemi dorëzuar për secilin punëtor:

- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga institucioni kompetent;
- Kontratën ose parakontratën;
- CV-në përkatëse.

Pra, të gjitha dokumentet e kërkuara nga Dosja e Tenderit janë dorëzuar.

Së dyti, pas pranimit të vendimit për eliminim, ne kemi kërkuar sqarim zyrtar nga Instituti i Mjekësisë së Punës, i cili ka lëshuar certifikatat në fjalë.

Me datë 11.06.2026, Instituti i Mjekësisë së Punës ka konfirmuar se:

- **Certifikatat janë lëshuar sipas procedurave të rregullta mjekësore;**
- **Janë nënshkruar nga të gjithë specialistët përkatës;**
- **Specialisti i Mjekësisë së Punës ka konstatuar se punëtorët janë "të aftë" për punë;**
- **Këto certifikata përdoren rregullisht për punëtorë që kryejnë punë në lartësi, përfshirë projekte të turbinave me erë në Kosovë dhe jashtë saj.**

AK nuk ka paraqitur asnjë bazë faktike apo ligjore që vërteton se certifikatat e dorëzuara nuk janë të vlefshme ose nuk dëshmojnë aftësinë e punëtorëve për kryerjen e punëve të kërkuara.

Për më tepër, në rast se AK ka pasur paqartësi lidhur me përmbajtjen e certifikatave, sipas

parimeve të proporcionalitetit dhe konkurrencës efektive, ka pasur mundësi të kërkojë sqarime shtesë lidhur me dokumentet e dorëzuara, e jo të eliminojë ofertën automatikisht.

Lidhur me certifikatat mjekësore të dorëzuara, theksojmë se nuk kemi as kompetencë ligjore dhe as mundësi praktike që të përcaktojmë, ndryshojmë apo plotësojmë përmbajtjen e certifikatave të lëshuara nga Instituti i Mjekësisë së Punës, i cili është organ kompetent dhe i autorizuar për vlerësimin e aftësisë shëndetësore të punëtorëve.

Këto certifikata janë dokumente zyrtare të lëshuara nga institucion publik/kompetent, i cili në mënyrë profesionale dhe ligjore përcakton gjendjen dhe aftësinë e punëtorit, përfshirë edhe aftësinë për kryerjen e punëve në lartësi. Operatorit Ekonomik nuk i lejohet dhe nuk i kërkohet të ndërhyjë në formulimin, përmbajtjen apo terminologjinë e përdorur nga institucioni lëshues.

Në këtë kuptim, çdo kërkesë që OE të “specifikojë” apo “qartësojë” përmbajtjen e një dokumenti zyrtar mjekësor, përtej asaj që është lëshuar nga institucioni kompetent, është juridikisht e paqëndrueshme.

Për rrjedhojë, pretendimi i AK-së se Operatori Ekonomik nuk e ka plotësuar këtë kriter është i pabazuar. Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, pasi gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave është bazuar në kërkesa dhe standarde që nuk janë përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Pas kërkeses për rishqyrtim, lidhur me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues se dokumenti është i paplotë dhe se nuk ka qenë e mundur të kërkohet sqarim sipas nenit 72 të LPP-së, theksojmë se ky interpretim është juridikisht i pabazuar.

Autoriteti Kontraktues pretendon se certifikatat shëndetësore CM0202 nuk specifikojnë se janë lëshuar për punë në lartësi dhe se çdo sqarim do të përbënte plotësim ose ndryshim të ofertës në kundërshtim me nenin 59.2 të LPP-së.

Ky pretendim nuk qëndron. Në rastin konkret, dokumenti i kërkuar nga Dosja e Tenderit ka ekzistuar dhe është dorëzuar brenda afatit për dorëzimin e ofertave. Autoriteti Kontraktues nuk ka konstatuar mungesën e certifikatave mjekësore, por vetëm ka vlerësuar se përmbajtja e tyre nuk është e mjaftueshme sipas interpretimit të tij. Prandaj, nuk kemi të bëjmë me mungesë dokumenti dhe as me tentativë për të plotësuar ofertën pas afatit, por vetëm me interpretimin e një dokumenti zyrtar që ishte pjesë e ofertës. Konfirmimi i lëshuar nga Instituti i Mjekësisë së Punës nuk përbën dokument të ri dhe nuk ndryshon ofertën. Ai vetëm sqaron përmbajtjen dhe domethënien e certifikatave të dorëzuara, të cilat kanë ekzistuar para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave.

Në këto rrethana, referimi i Autoritetit Kontraktues në nenin 59.2 të LPP-së është i pasaktë, pasi ne nuk kemi kërkuar të ndryshojmë, zëvendësojmë apo plotësojmë ofertën, por vetëm kemi kundërshtuar interpretimin subjektiv të bërë nga Autoriteti Kontraktues lidhur me një dokument që ishte pjesë përbërëse e ofertës së dorëzuar brenda afatit ligjor.

Pretendimi 2 - Vlerësim jo konsistent dhe arbitrar i certifikatave

mjekësore

Nga Raporti i Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit të Tenderëve rezulton se Autoriteti Kontraktues ka aplikuar një qasje jo konsistente gjatë vlerësimit të certifikatave mjekësore të kërkuara për punëtorët që kryejnë punë në lartësi.

Konkretisht, operatorët ekonomikë **Luigj Kastrati** dhe **I.E.C.-BIO L.L.C.** janë eliminuar me arsyetimin se kanë dorëzuar formularin **CM0201** dhe se **dokumenti zyrtar për punë në lartësi është formulari CM0202.**

Ndërkohë, Kompania jone **AR-Tech Sh.P.K.** ka dorëzuar pikërisht **formularin CM0202**, por është eliminuar me arsyetimin se në dokument nuk është specifikuar apo përcaktuar puna në lartësi.

Theksojmë se pajtohemi me eliminimin e operatorëve ekonomikë të tjerë lidhur me këtë kriter dhe nuk kontestojmë vlerësimin e bërë ndaj tyre. Megjithatë, kundërshtojmë eliminimin e ofertës sonë, pasi nga vetë Raporti i Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit të Tenderëve rezulton se Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se formulari CM0202 është dokumenti përkatës për dëshmimin e aftësisë së punëtorëve për punë në lartësi.

Pra operatorët ekonomikë që kanë dorëzuar formularin CM0201 janë eliminuar me arsyetimin se dokumenti i duhur për punë në lartësi është formulari CM0202. Ndërsa kompania jonë, e cila ka dorëzuar formularin CM0202, është eliminuar me arsyetimin se në këtë dokument nuk është specifikuar apo përcaktuar puna në lartësi.

Nuk është e arsyeshme që i njëjti Autoritet Kontraktues, në të njëjtin raport të vlerësimit, të konstatojë se formulari CM0202 është dokumenti i duhur për punë në lartësi, ndërsa njëkohësisht të eliminojë ofertën tonë që e kemi dorëzuar pikërisht këtë formular, duke kërkuar elemente shtesë. Një kontradiktë e tillë nuk mund të justifikohet me një interpretim objektiv të kërkesës, por krijon indicie të forta se kriteri është interpretuar në mënyrë selektive dhe me rezultat të paracaktuar – eliminimin e ofertës sonë.

Pretendimi 3 - Lidhur me pretendimin për mungesë të metodologjisë së kryerjes së punimeve

Kërkesa e Dosjes së Tenderit

Në Specifikimin Teknik është kërkuar: "Ofertuesi duhet të paraqes metodologjinë e kryerjes së punimeve për këtë lloj të punimeve."

Specifikimi teknik më tej përmend:

- "Punët përgatitore, sigurimin e vend-punishtes gjatë ekzekutimit të punimeve, e organizon dhe implementon vet kontraktori dhe kjo është përgjegjësi e tyre." si dhe
- "Gjatë implementimit të projektit, inxhinieri përcjellës i punimeve është i obliguar të mbajë ditar të zhvillimit të punimeve dhe çdo ditë ka takim të rregullt me Projekt Menaxherin."

Në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit nuk është përcaktuar **forma, struktura, përmbajtja**

minimale apo numri i faqeve që duhet të përmbajë metodologjia.

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues ne letren standarde

"Në ofertë nuk keni dorëzuar metodologji të juajën për kryerje të punëve, dokumenti që e keni emërtuar 'Metodologjia e kryerjes së punëve' është e kopjuar nga Dosja e Tenderit."

Bazuar në këtë konstatim, AK ka vlerësuar se nuk kemi përmbushur kërkesën e Specifikimit Teknik.

Argumenti 3

Ne nuk nuk pajtohemi me këtë konstatim për faktin se dokumenti i dorëzuar me titull "Metodologjia e kryerjes së punëve" nuk përbëhet vetëm nga tekst i marrë nga Dosja e Tenderit.

Në metodologjinë e dorëzuar janë përfshirë elemente konkrete të Operatorit Ekonomik, të cilat nuk gjenden në Dosjen e Tenderit, si:

- Përdorimi i metodës mekanike për deblokimin e bunkerit të zgjyrës B1 dhe B2;
- Përshkrimi i masave mbrojtëse ndaj pajisjeve gjatë procesit të deblokimit;
- Përcaktimi i pajisjeve dhe veglave që do të përdoren gjatë realizimit të punimeve;
- Organizimi i kryerjes së punimeve në terren;
- Pastrimi dhe dorëzimi i vendpunishtes pas përfundimit të punimeve;
- Koordinimi me organin mbikëqyrës të caktuar nga punëdhënësi.

Fakti që në metodologji janë përfshirë edhe disa pjesë të Specifikimit Teknik nuk e bën dokumentin të papranueshëm dhe as nuk dëshmon mungesën e metodologjisë.

Për më tepër, Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar asnjë kërkesë që metodologjia duhet të jetë tërësisht origjinale apo që **përfshirja e elementeve të Specifikimit Teknik përbën arsye për eliminim.**

Gjithashtu, Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar format, strukturën, përmbajtjen minimale apo kriteret sipas të cilave do të vlerësohej metodologjia. Në mungesë të këtyre kërkesave, Autoriteti Kontraktues nuk mund të aplikojë kritere subjektive pas hapjes së ofertave dhe të eliminojë një operator ekonomik për arsye që nuk janë publikuar paraprakisht në Dosjen e Tenderit.

Neni 59 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues që gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave të kufizohet vetëm në kërkesat dhe kriteret e publikuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Në rastin konkret, Dosja e Tenderit ka kërkuar vetëm paraqitjen e metodologjisë së kryerjes së punimeve, pa përcaktuar format, strukturën, nivelin e detajimit apo kriteret sipas të cilave do të vlerësohej metodologjia. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën tonë duke aplikuar një kriter shtesë, respektivisht duke vlerësuar në mënyrë subjektive se metodologjia nuk ishte **"e juaja" dhe se ishte "e kopjuar nga Dosja e Tenderit"**.

Një kriter i tillë nuk është paraparë askund në Dosjen e Tenderit dhe për rrjedhojë paraqet

zbatim të kriterëve të reja pas hapjes së ofertave, në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Kur Autoriteti Kontraktues aplikon standarde ose kritere që nuk janë publikuar paraprakisht në Dosjen e Tenderit dhe i përdor ato si bazë për eliminim, ai cenon parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Kundër-argument ndaj arsyetimit të AK për Metodologjinë në Vendimin mbi refuzimin e Kërkeses për rishqyrtim

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim është i pabazuar në kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe përbën interpretim selektiv dhe subjektiv të përmbajtjes së ofertës.

Së pari, Dosja e Tenderit ka kërkuar vetëm “paraqitjen e metodologjisë së kryerjes së punimeve”, pa përcaktuar strukturë, format, nivel detajimi apo ndalim të përdorimit të pjesëve të Specifikimit Teknik. Në mungesë të këtyre kufizimeve, çdo formë e përshkrimit teknik dhe organizativ të punimeve përbën metodologji të pranueshme në kuptim të kërkesës së DT-së.

Së dyti, vetë arsyetimi i AK-së është kontradiktor: AK pranon që dokumenti përmban tekst që lidhet me organizimin e punimeve dhe pajisjet e nevojshme, por njëkohësisht e refuzon atë vetëm sepse përmban fragmente të njëjta me Dosjen e Tenderit. Kjo qasje nuk është e bazuar në ndonjë kriter të DT-së, por në një standard të krijuar pas hapjes së ofertave, gjë që ndalohet shprehimisht me nenin 59 të LPP-së.

Fakti që një pjesë e tekstit përputhet me Specifikimin Teknik nuk e zhvesh dokumentin nga karakteri i tij si metodologji, përkundrazi, tregon se ofertuesi ka ndërtuar metodologjinë mbi kërkesat teknike të projektit. Asnjë dispozitë e Dosjes së Tenderit nuk ndalon ripërdorimin e kërkesave teknike si pjesë e përshkrimit të metodologjisë, dhe as nuk kërkon që metodologjia të jetë “tekst krejtësisht i ndryshëm” nga DT.

Së treti, pretendimi i AK-së se “teksti është i shkruar si kërkesë dhe jo si deklaratë metodologjike” është vlerësim subjektiv dhe formalist, i cili nuk bazohet në asnjë kriter të paracaktuar. Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar formatin narrativ të metodologjisë, nuk ka kërkuar stil të veçantë shkrimi dhe as nuk ka ndaluar përdorimin e gjuhës përshkruese që përputhet me specifikimet teknike.

Në mungesë të kriterëve të tilla, Autoriteti Kontraktues nuk mund të zëvendësojë kërkesën “paraqitje e metodologjisë” me një kërkesë të re të nënkuptuar, si “metodologji që nuk përmban tekst nga DT” apo “metodologji e shkruar në formë të ndryshme nga specifikimet”. Një qasje e tillë përbën shtim të kriterit pas hapjes së ofertave dhe bie drejtpërdrejt ndesh me nenin 59 të LPP-së.

Së katërti, pretendimi se dokumenti “nuk elaboron mjaftueshëm metodologjinë” është gjithashtu i paqëndrueshëm juridikisht, pasi Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar nivel minimal të elaborimit, nuk ka kërkuar kapituj të detyrueshëm dhe nuk ka vendosur standard vlerësimi cilësor për metodologjinë. Në këto kushte, Autoriteti Kontraktues nuk mund të aplikojë një test subjektiv të “mjaftueshmërisë” si bazë për eliminim.

Pretendimi 4 - Shkelje e nenit 6 të LPP-së (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)

Oferta jonë në vlerë prej 39,825.00 Euro është oferta me çmimin më të ulët dhe eliminimi i saj pa bazë ligjore bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, konkurrencës efektive dhe përdorimit efikas të fondeve publike.

Eliminimi i një oferte që plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit, mbi baze të interpretimit subjektiv, është në kundërshtim me parimin e përdorimit ekonomik dhe efikas të fondeve publike, të përcaktuar në nenin 6 të LPP-së.

Pretendimi 5 - Model i qartë i vlerësimit jo objektiv, jo konsistent dhe në kundërshtim me LPP-në , Sheklje e nenin 7 dhe 59 te LPP

Nga analizimi i të gjitha pretendimeve të elaboruara më sipër, rezulton qartë se mënyra e vlerësimit të ofertës sonë nuk përfaqëson një proces të rregullt, objektiv dhe të bazuar në kërkesat e Dosjes së Tenderit, por një qasje të paqëndrueshme, selektive dhe juridikisht të cenueshme nga Autoriteti Kontraktues.

Në veçanti, gjatë vlerësimit janë evidentuar këto devijime thelbësore:

- CM0202 janë vlerësuar në mënyrë të ndryshme për operatorë të ndryshëm ekonomikë, duke krijuar standarde të dyfishta brenda të njëjtit kriter;
- janë aplikuar kërkesa shtesë që nuk figurojnë në Dosjen e Tenderit, si p.sh. kërkesa e nënkuptuar që metodologjia duhet të jetë “e ndryshme nga DT”;
- është aplikuar një vlerësim subjektiv i metodologjisë së punimeve, duke u bazuar në interpretim formalist dhe jo në kërkesat e publikuara paraprakisht.

Ky model i vlerësimit tregon mungesë të një metodologjie të unifikuar dhe të parashikueshme të ekzaminimit të ofertave, duke rezultuar në trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë dhe cenim të parimeve themelore të prokurimit publik.

Në këtë kontekst, nuk bëhet fjalë për gabime të izoluara teknike në vlerësim, por për një qasje të përsëritur të interpretimit të ndryshëm të të njëjtave kërkesa, e cila në efekt ka rezultuar në eliminimin e ofertës sonë përmes aplikimit të standardeve që nuk janë paraparë në Dosjen e Tenderit.

Një qasje e tillë bie drejtpërdrejt ndesh me:

- **nenin 7 të LPP-së**, që garanton trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim;
- **nenin 59 të LPP-së**, që kufizon vlerësimin vetëm në kërkesat e DT-së;
- si dhe parimet themelore të transparencës, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike.

Në këto rrethana, vendimi i Autoritetit Kontraktues është rezultat i një procesi vlerësimi jo të njëtrajtshëm dhe juridikisht të pasaktë, i cili ka cenuar në mënyrë substanciale të drejtën e operatorit ekonomik për trajtim të barabartë dhe konkurrencë të drejtë.

Pretendimi 6 – Shkelje e Nenit 61 dhe 63 te Rregullores se Prokurimit publik

AK, respektivisht KEK ka shkelur dispozitat e mëposhtme të Rregullores së Prokurimit Publik:

- **Neni 61.3** percakton “*Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të publikojë Kërkesën për rishqyrtim në Platformë tek dosja e tenderit*”

në “shto dokument shtesë” dhe do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës”

- **Neni 63.2** percakton “Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik si “Dokument shtesë” tek dosja e tenderit nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit”.

Në rastin konkret, KEK. **nuk ka respektuar këto dispozita**, pasi nuk ka:

1. Nuk ka publikuar kërkesën për rishqyrtim në Platformë;
2. Nuk ka publikuar vendimin e Autoritetit Kontraktues mbi refuzimin e kërkesës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke eliminuar padrejtësisht ofertën tonë, gjë që ka shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta materiale, përfshirë:

- Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionit mbështetës;
- Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundshme;
- Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet.

Për këto arsye, duke u mbështetur në Ligjin për Prokurimin Publik dhe rregulloren përkatëse, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

1. **Të anulojë Njoftimin mbi Vendimin e datës 10.06.2026;**
2. **Të kthejë çështjen në procedurë të ri-vlerësimit;**
3. **Si rrjedhojë, të shpallë ofertën tonë si të përgjegjshme.**

Kjo kërkesë është në funksion të respektimit të parimeve të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. një kopje e Njoftimit mbi kontrate
2. një kopje e Njoftimit mbi Vendimin e AK
3. një kopje e Kërkeses për rishqyrtim
4. një kopje të vendimit të AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
5. Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
6. të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

7. Nje kopje e pergjigjes se **Institutit te Mjekësisë së Punës**

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*